



2. Titulli i vendit të punës: Operues me pajisje dhe sisteme termoeenergjetike:

Qëllimi i vendi të punës

Operimi me pajisje sisteme termoeenergjetike, klimatizim, ventilim, sisteme solare dhe enëve nën presion.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Është i obliguar që gjatë orarit të punës t'i përmbahet masave të mbrojtjes në punë, standardeve teknike për pajisjen që e ka në përdorim dhe udhëzimeve për punë për pajisje të kësaj natyre.
- Është e obliguar që gjatë orarit të punës të bashkëpunojë me personelin e klinikës dhe të plotësoj kërkesat e personelit të autorizuar mjekësor që kanë të bëjnë me përdorimin – Operimin me pajisje sisteme termoeenergjetike, duke përfshirë klimatizimin me ventilim dhe sistemin solar.
- Kontrollon pajisjen, gjendjen funksionale dhe paralajmëron për këtë udhëheqësin e drejtpërdrejtë.
- Është përgjegjës për pajisjen që e ka në disponim që ta kontrolloj, mirëmbajë dhe t'ia mirë përdorë ashtu që pajisja të jetë në gjendje funksionale dhe në gjendje gatishmëri për përdorim kurdo që është e nevojshme.
- Është i obliguar që t'i përmbahet udhëzimeve për punë që jepen nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
- Për çdo defekt apo parregullsi të pajisjes që e vëren gjatë orarit të punës, duhet të ndërmerr masat në kuadër të njohurive dhe menjëherë e lajmëron udhëheqësin e drejtpërdrejtë për masat e mëtejme.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të Shërbimit.
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të njësisë punuese.

Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar:

Diploma e Shkollës së Mesme - dega e makinerisë.

Kushtet tjera të kërkuara janë të njëjta me dy operatorët e parë.

Mentor Zejnullahu

U.D. Drejtor i QKUK-së